



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 7 prot.

Kamëz, më 17.1.2022

V E N D I M

Nr. 7 Datë 17.1 2022

M B I

“MIRATIMIN E KRIJIMIT TË TRUPËS E ARTIT SKENIK PËR PALLATIN E
KULTURËS DHE PAGESËS SË TYRE NËPËRMJET HONORAREVE”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 17.1.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.07 Datë 14.1.2022 në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, në VKB nr.160 datë 23.12.2020 “Për miratimin e detajimit të buxhetit për vitet 2021, 2022, 2023” i ndryshuar; **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I:

1. Miratimin e dhënies së honorareve për vitin 2022 për grupin e Artit Skenik, 8 (tete) çifte, të cilët do të shërbejnë për të performuar në aktivitete të cilat do të zhvillohen nga pallati i kulturës sipas një kalendari pune vjetor duke performuar në shërbim të aktiviteteve të bashkisë.
 - 1.1 Secilit person do ti lidhet kontrata 1 vjeçare me të drejtë rinovimi nqs vlerësimi i performancës i bazuar në vlerësimin e Komisionit të Profesionistëve të Pallatit të Kulturës.
 - 1.2 Pagesa do të jetë kundrejt shumës 5000 (pesë mijë lekë) çdo muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

2. Të miratojë dhënien e honorareve për grupin e Formacionit Orkestral, të cilët do të performojnë në aktivitete të cilat do të zhvillohen nga pallati i kulturës sipas një kalendari pune vjetor duke performuar në shërbim të aktiviteteve të bashkisë.
 - 2.1 Grupi i formacionit orkestral ka detyrim paraqitje për tu përgatitur për provat sa herë që të thirret nga drejtori i pallatit të kulturës.
 - 2.2 Instrumentisti do të paguhet sa herë që do të thirret për të performuar në aktivitete kundrejt shumës 10 000 (dhjetë mijë lekë).
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

Kryetar Këshilli
Hysen Koldashi

